FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 83	2002	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8974 datë 21.11.2002	Për disa shtesa në ligjin nr.8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve"…….	2389
Ligj nr. 8975 datë 21.11.2002	Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv…… ……..	2391
Dekret nr. 3557 datë 14.11.2002	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese……	2391
Dekret nr.3609 datë 20.12.2002	Për falje dënimi……..…….	2392
Dekret nr. 3617, datë 26.12.2002	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Llugaj (Tropojë), qarku Kukës……	2393
Vendim i KM nr. 640, datë 12.12.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për shitjen e mjeteve dhe të teknikës luftarake të ushtrisë, të dala jashtë përdorimit në formën e skrapeve", ndryshuar me vendimin nr. 444, datë 26.9.2002 të Këshillit të	2394

	Ministrave…….	
Vendim i KM nr. 644, datë 12.12.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 400/110 kv, në Zemblak……	2394
Vendim i KM nr. 645, datë 12.12.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga zgjerimi i nënstacioneve Elbasan 400 kv, Elbasan 220 kv, dhe nga ndërtimi i linjës 220 kv ndërmjet tyre…….	2396
Vendim i KM nr. 646, datë 12.12.2002	Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit, në fushat e industrisë dhe të energjetikës, të cilat duhet të marrin statusin "Rregulla teknike" të detyrueshme për zbatim……..	2398
Shtesë autorizimi zyrtar nr. 1, datë 20.7.2002	Për të vepruar si shoqëri sigurimi. Leje e riformuluar për zgjerimin të aktivitetit të sigurimeve dhe/ose risigurimeve.	2403

L I G J
Nr.8974, datë 21.11.2002

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8691, DATË 16.11.2000 "PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E DUHANIT DHE TË CIGAREVE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve" bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19 shtohet neni 19/a si më poshtë:

"Produktet e duhanit që tregtohen në Shqipëri duhet të përmbajnë në ambalazh, respektivisht etiketën e tyre, të dhëna për përmbajtjen e katranit dhe nikotinës. Këto të dhëna duhet të maten në bazë të standardeve ndërkombëtare në fuqi.

Të dhënat për katranin dhe nikotinën në paketat e cigareve duhet të shtypen në një faqe anësore të paketës, në gjuhën shqipe, me shkrim të lexueshëm qartë dhe në kontrast me sfondin, në një sipërfaqe që zë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes respektive të faqes anësore të paketës."

Neni 2

Pas nenit 19/a shtohet neni 19/b si më poshtë:

"Në çdo pako duhani duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, në pjesën më të dukshme të tij, paralajmërimi i përgjithshëm "Duhani dëmton rëndë shëndetin".

Në paketat e cigareve paralajmërimi i përgjithshëm në gjuhën shqipe "Duhani dëmton rëndë shëndetin" duhet të shkruhet në faqen e madhe ballore të paketës, ndërsa në faqen tjetër ballore duhet të shkruhet në gjuhën shqipe njëri nga paralajmërimet alternative:

- "Pirja e duhanit shkakton kancer"
- "Pirja e duhanit shkakton sëmundje të zemrës"
- "Pirja e duhanit shkakton sëmundje vdekjeprurëse"
- "Pirja e duhanit shkakton kancer, bronkit kronik dhe sëmundje të tjera të kraharorit"
- "Pirja e duhanit dëmton shëndetin e njerëzve që ju rrethojnë"
- "Mbroni fëmijët nga duhani"
- "Pirja e duhanit nga gratë shtatzëna dëmton fëmijën".

Paralajmërimet alternative duhet të shtypen në paketa në mënyrë të tillë që të garantohet shpërndarja e barabartë e tyre në produktet e prodhuara, me një tolerancë prej rreth pesë për qind.

Paralajmërimet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni duhet të zënë jo më pak se 10 për qind të sipërfaqes së secilës nga faqet ballore të paketës. Paralajmërimet duhet të shkruhen me shkrim të qartë dhe të lexueshëm, me shkronja të trasha dhe në kontrast me sfondin, nuk duhet të shtypen në pjesë që mund të dëmtohen nga hapja e paketës, si dhe nuk duhet të shtypen në mbështjellësen transparente ose në ndonjë mbështjellëse tjetër të jashtme.

Për produktet e tjera të duhanit, paralajmërimi i përgjithshëm i përmendur në paragrafin e parë duhet të shtypet në ambalazh ose të ngjitet mbi të, duke u vendosur në pjesët më të dukshme të tij, në kontrast me sfondin dhe në mënyrë që të jetë i dukshëm dhe i lexueshëm qartazi. Në çdo rast, nuk duhet të bëhet e mundur fshehja, mbulimi ose ndërprerja e tij nga pamja ose shkrime të tjera."

Neni 3

Pas nenit 19/b shtohet neni 19/c si më poshtë:

"Duke filluar nga data 31 mars 2003, për importuesit dhe për prodhuesit vendas ndalohet tregtimi i produkteve të duhanit që nuk plotësojnë kushtet lidhur me etiketimin, të përmendura në nenet 19/a dhe 19/b të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë."

Neni 4

Në nenin 22, në rreshtin e parë të shkronjës "c", pas fjalëve "me kërkesat e nenit 19" shtohen fjalët: "shkronjat "a", "b", "c",".

Neni 5

Në nenin 22, pas shkronjës "c" shtohet paragrafi c/1 si më poshtë:

"Tregtimi i produkteve të duhanit në kundërshtim me kërkesat e neneve 19/a, 19/b dhe 19/c të këtij ligji në territorin e Republikës së Shqipërisë dënohet me konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve të duhanit dhe me heqjen e lejes përkatëse."

Neni 6

Pas pikës 1 të nenit 23 shtohet pika 2 si më poshtë:

"Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ajo e Doganave janë përgjegjëse për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve, paketimi i të cilave nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji."

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.8974 , datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.8975, datë 21.11.2002

PËR TRAJTIMIN E FATURAVE TATIMORE TË UJIT TË PIJSHËM SI TITULL EKZEKUTIV

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të nenit 36 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tij".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3611, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr.3609, datë 20.12.2002

PËR FALJE DËNIMI

Në mbështetje të neneve 92 pika b dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të organeve të pushtetit lokal dhe Ministrisë së Drejtësisë, me rastin e Festave të fundviti,

D E K R E T O J:

Neni 1

1. Ram Sali Matoshi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.281, datë 18.11.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
2. Ilmi Nuredin Elezi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Porgradec, me vendimin nr.62, datë 8.9.1987, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
3. Selim Rexhep Shavelli, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.357, datë 4.5.1998, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
4. Ndue Gjon Gega, dënuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, me vendimin nr.10, datë 26.2.1999, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
5. Besnik Ramadan Lukaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, ne vendimin nr.64, datë 14.4.1990, i falet dënimi i mbetur.
6. Astrit Ramadan Lujkaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.64, datë 14.4.1990, i falet dënimi i mbetur.
7. Arian Lirim Husi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.843, datë 26.12.2000, i falet dënimi i mbetur.
8. Adil Eqerem Dushku, dënuar nga Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.22, datë 24.01.2000, i falet dënimi i mbetur.
9. Viktor Rexhep Caca, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tepelenë, ne vendimin nr.45, datë 8.12.2000, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
10. Vladimir Ramadan Koromani, dënuar nga Gjykata e Rrethit Skrapar, me vendimin nr.20, datë 23.9.1999, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.
11. Agim Muharren Egro, dënuar nga Gjykata e rrethit Tiranë, me vendimin nr.48, datë 5.2.1998, i falen 2 vjet dënimi i mbetur.
12. Kosta Ramadan Lilollari, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pogradec, me vendimin nr.38, datë 5.7.1999, i falet dënimi i mbetur.
13. Prel Martin Bleta, dënuar nga Gjykata e Rrethit Shkodër,me vendimin nr.191, datë 23.6.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.
14. Agron Agim Goxhaj, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.639, dtë 18.10.2000, i falet dënimi i mbetur.
15. Myftar Skënder Saliko, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kolonjë, me vendimin nr.7, datë 5.9.1994, i falen 32 vjet nga dënimi i mbetur.
16. Eugen Hajri Liça, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tepelenë, ne vendimin nr.7, datë 7.6.2001, i falen 4 vjet nga dënimi i mbetur.
17. Flogert Preng Kola, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.81, datë 12.2.2002, i falet d]nimi i mbetur.
18. Dilaver Mulla Çopa, dënuar nga Gjykata e Rrethit Kavajë, me vendimin nr.63, datë

18.6.2000, i falet 1 vit nga dënimi i mbetur.

19. Bujar Rasim Laçi, dënuar nga Gjykata e Rrethit Pukë, me vendimin nr.74, datë 23.11.2000, i falet dënimi i mbetur.

20. Enver Halil Sefa, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.1, datë 1.6.2000, i falen 2 vjet nga dënimi i mbetur.

21. Njazi Dervish Mahili, dënuar nga Gjykata e Rrethit Sarandë, me vendimin nr.51, datë 15.9.1994, i falen 4 vjet nga dënimi i mbetur.

22. Hazis Muharrem Perzhilla, dënuar nga Gjykata e Rrethit Dibër, me vendimin nr.25, datë 12.4.1994, i falet dënimi i mbetur.

23. Lutfi Qazim Cani, dënuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, ne vendimin nr.297, datë 29.5.1993, i falet dënimi i mbetur.

24.Sadik Avdulla Kërteca, dënuar nga Gjykata e Rrethit Durrës, me vendimin nr.167, dtë 12.6.2002, i falet d]ënimi i mbetur.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr. 3557, datë 14.11.2002

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 125, pika 1, të Kushtetutës,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Xhezair Zaganjori, emërohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr. 640, datë 12.12.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 828, DATË 30.12.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT NË FORMËN E SKRAPEVE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 444, DATË 26.9.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 pika 7 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i

Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në lidhjen A, në listën që i bashkëlidhet vendimit, numri rendor 2 "Nëndetësja 332, Tufani" dhe numri rendor 4 "Nëndetësja 334, Vetëtima", hiqen nga lista dhe kalojnë e regjistrohen si objekteve muzeale në Muzeun e Forcave Detare, pranë Akademisë së Detarisë, Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

D E K R E T
Nr. 3617, datë 26.12.2002

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË KOMUNËN LLUGAJ (TROPOJË), QARKU KUKËS

Në mbështetje të nenit 92, germa "gj" të Kushtetutës, si dhe të neneve 4 dhe 11, pika 5, të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8780, datë 3.5.2001, bazuar në njoftimin e Kryeministrit,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Llugaj (Tropojë), të Qarkut Kukës, të zhvillohen ditën e dielë, datë 26 janar 2003, ndërsa raundi i dytë të zhvillohet ditën e dielë, datë 9 shkurt 2003.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr. 644, datë 12.12.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/11KV, NË ZEMBLAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 400/110 kv, në Zemblak, Korçë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së, Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 34 462 010 (tridhjet e katër milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dhjetë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i KESH, sh.a.-së, Tiranë, zëri "Kosto lokale për shpronësime".

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 171 500 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë dhe të jetë në ngarkim të KESH, sh.a.-së, kërkuesit për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë brenda vitit 2002 dhe të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2003.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni të fillojnë brenda vitit 2002 dhe të përfundojnë në dhjetor të vitit 2003.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Qarku KORÇË

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 400/110 KV i ZEMBLAKUT KORÇË

Lloji i pasurisë së paluajtshme : **Tokë bujqësore**

Pronarët, pozicioni kadastral, sipërfaqet që do të shpronësohen dhe vlera e kompesimit

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e N/Stacionit m/2	Sipërfaqja Shtyllë m/2	Sipërfaqia Rrugë m/2	Sipërfaqja Përgjithshme m/2	Çmimi lekë/m2	Vlera e kompesimit në lekë
1.	Isuf	Ramadan	Bujari	112/11	57.64			57.64	1000	57.640
2.	Nikolla	Njazi	Bujari	112/9	522.54			522.54	1000	522.540
3.	Resmi	Njazi	Bujari	112/8	1060.56		272.02	1332.58	1000	1.332.580
4.	Natasha Mihali Vasil	Njazi Kosta Kosta	Karamika Karamika Karamika	112/7	182.45	51.11	100.75	334.31	1000	334.310
5.	Sotir	Njazi	Bujari	112/6		48.89	3.63	52.52	1000	52.520
6.	Myfterem	Njazi	Bujari	112/5		44.32		44.32	1000	44.320
7.	Gezim	Halit	Mullalli	112/12	910.61			910.61	1000	910.610
8.	Fatbardh	Halit	Mullalli	112/13	279.00			279.00	1000	279.000
9.	Azem	Mahmut	Mullalli	112/14	721.51		78.25	799.76	1000	799.760
10.	Nexhat	Servet	Mullalli	112/15		55.68	11.14	66.82	1000	66.820
11.	Florenc	Islam	Kulla	112/18	1313.74	30.19	57.33	1401.26	1000	1.401.260
12.	Meleq	Muarrem	Bujari	112/19	1265.6	69.81	49.95	1385.36	1000	1.385.360
13.	Xhevit	Muarem	Kulla	112/20	2762.19		100.76	2862.95	1000	2.862.950
14.	Vaide	Selim	Bujari	112/21	2015.35		59.73	2075.08	1000	2.075.080
15.	Haxhi	Demir	Kulla	112/22	2404.78		68.15	2472.93	1000	2.472.930
16.	Inajet	Bexhet	Kulla	112/23	3511.87		92.99	3604.86	1000	3.604.860
17.	Myzafer	Refik	Kulla	112/24	3507.12		100.15	3607.27	1000	3.607.270
18.	Nexhat	Hamit	Kulla	112/25	3957.5		114.63	4072.13	1000	4.072.130
19.	Avni	Demirali	Shaholli	112/26	3110.57		98.69	3209.26	1000	3.209.260
20.	Syria	Demirali	Shaholli	112/27	1966.94		78.71	2045.65	1000	2.045.650
21.	Arif	Refik	Kulla	112/28	1996.14		153.13	2149.27	1000	2.149.270
22.	Sotiraq	Rahmi	Kulla	112/29	858.35			858.35	1000	858.350
23.	Edmont	Abeli	Kulla	112/30	317.54			317.54	1000	317.540
	SHUMA				**32722.00**	**300.00**	**1440.01**	**34462.01**		**34 . 462. 010**

Shënim : Mbyllet me numrin rendor 23 (njëzet e tre)

Vlera totale e kompesimit të pronarëve 34.462.010 (tridhjetëekatërmilionekatërqindegjashtëdhjetëedymijëedhjetë) lekë.
Shpenzime proceduriale (publikim,kancelari,shpërblim) 171.500 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë
Vlera e përgjithshme e shpronësimit 34.633.510 (tridhjetëekatërmilionegjashtëqindetridhjetëetremijëepesëqindedhjetë)lekë.

V E N D I M
Nr. 645, datë 12.12.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA ZGJERIMI I NËNSTACIONEVE ELBASAN 400 KV, ELBASAN 220 KV, DHE NGA NDËRTIMI I LINJËS 220 KV NDËRMJET TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i nënstacioneve Elbasan 400 kV, Elbasan 220 kV dhe nga ndërtimi i linjës 220 kV ndërmjet tyre, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH-, sh.a.-së, Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen dhe pronarët e pasurive që dëmtohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi në shumën e përgjithshme prej 9 167 098 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, me sipërfaqe 2 900 m2 truall, 232 m2 ndërtesë, 5290 m2 tokë arë, 1 400 m2 parcelë me misër, 697 m2 parcelë me jonxhë.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e miratuara për KESH, sh.a.-së, në zërin "Kosto lokale për shpronësime".

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit në shumën 287 000 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të jenë në ngarkim të KESH, sh.a.-së, kërkuesit për shpronësim.

6. Procedura e shpronësimit të fillojë brenda tremujorit të katërt të vitit 2002 dhe të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2003.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Republika e Shqipërisë
Rrethi Elbasan

Lista e pronarëve që preken nga shpronësimi për ndërtimin e nënstacioneve Elbasan 400 kV, Elbasan 220 kV, si dhe nga linja 220 kV ndërmjet tyre

Lloji i pasurisë së paluajtshme që preket dhe shpronësimet nga zgjerimi i nënstacionit Elbasan 400 kV: kantier prodhimi material ndërtimi dhe tokë arë.

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Sip. në m2	Vlera totale e pasurisë	Adresa:	Shënime
1	Arif Terziu	a)Truall b)ndërtesë	2 900 232	6.016.398 lekë	Lagjia:Fushë-Mbret Elbasan	I regjistruar
2	Bexhet Limani (përdorues)	Tokë arë	2653	Nuk kompesohet Pronë shtetërore	Lagjia: Fushë-Mbret Elbasan	Pronë-shtetërore dhënë në përdorim

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Lloji i pasurisë së paluajtshme që preket dhe shpronësohet nga zgjerimi i nënstacionit Elbasan 220 kV si dhe nga ndërtimi i linjës 220 kV ndërmjet dy nënstacioneve: Tokë-arë.

Nr	Emër mbiemër	Nr. kadastral	Lloji i pasurisë	Sip.në m2	Çmimi lekë/m2	Vlera e pasurisë që kompensohet shprehur në lekë	Adresa	Shënime
1	Veli Leshanaku	72	Tokë arë	1 400	1200	1 680 000	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
2	Arben Leshanaku	72	Tokë arë	697	"	836 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
3	Jakup Leshanaku	72	Tokë arë	42	"	50 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
4	Nuredin Leshanaku	69	Tokë arë	42	"	50 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
5	Selman Leshanaku	140	Tokë arë	15	"	18 000	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
6	Met Leshanaku	140	Tokë arë	15	"	18 000	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
7	Banush Salla	141	Tokë arë	86	"	103 200	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
8	Agim Hidri	189	Tokë arë	25.5	"	30 600	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
9	Zyber Kraoba	198	Tokë arë	34	"	40 800	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
10	Jakov Bërdufi	37	Tokë arë	52	"	62 400	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
11	Misir Myrto	331	Tokë arë	56	"	67 200	Komuna Bradashesh	Proc. Regjistrimi
12	Xhaferr Pajenga	331,2	Tokë arë	43	"	51 600	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
13	Shpëtim Gjeli	332,2	Tokë arë	21.5	"	25 800	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
14	Xhavit Hani	339 0/1	Tokë arë	36	"	43 200	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
15	Shpresa Ruci	338 4	Tokë arë	30	"	36 000	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi
16	Bexhet Limani (përdorues)	428	Tokë arë	42	"	Nuk kompesohet Pronë shtetërore	Lagja: Skënderbej	Proc. Regjistrimi

Mbyllet me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë)

3. Lloji i pasurisë që dëmtohet nga shpronësimi: Kulturë bujqësore misër dhe jonxhë:

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë së dëmtuar	Sip.e mbëdhjellë në m2	Vlefta totale e pasurisë që zhdëmtohet	Adresa:
1	Veli Leshanaku	Parcelë me misër	1400	23 300 lekë	Bradashesh-Elbasan
2	Arben Leshanaku	Parcelë me jonxhë	697	13 400 lekë	Bradashesh-Elbasan

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Shënim: Vlera totale e kompensimit të pronarëve 9 167 098 (nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

Shpenzime procedurale (publikim, kancelari, shpërblim) 287 000 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

Vlera e përgjithshme e shpronësimit 9 454 098 (nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

V E N D I M
Nr. 646, datë 12.12.2002

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE TË PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT, NË FUSHAT E INDUSTRISË DHE TË ENERGJETIKËS, TË CILAT DUHET TË MARRIN STATUSIN "RREGULLA TEKNIKE" TË DETYRUESHME PËR ZBATIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 "Për standartizimin", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e standardeve dhe të mallrave e produkteve, që krijojnë hapësirë për elementë abuzivë, për sigurinë e jetës, të shëndetit, mbrojtjes së mjedisit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat duhet të marrin statusin "Rregulla teknike", të detyrueshme për zbatim.
2. Miratimin e kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat duhet të marrin statusin "Rregulla teknike", të detyrueshme për zbatim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1
LISTA E STANDARDEVE TË DETYRUESHME AKTUALISHT NË FUQI QË MIRATOHEN NË "RREGULLA TEKNIKE" TË DETYRUESHME PËR ZBATIM:

I. Naftë, gaz dhe produkte nafte

1	SSH 51:1988	Naftë bruto
2	SSH 97:1997	Gaz i lëngshëm nga nafta
3	SSH 24:1986	Bitum i pastruar (Selenice)
4	SSH 23:96	Benzinë normale shqiptare
5	SSH 50:1996	Vajguri për përdorim komunal
6	SSH 3650:1986	Lëndë djegëse për kaldaja
7	SSH EN 590-2000	Lëndë djegëse për automjete me motor diezel
8	SSH 163:1986	Vaj lubrifikant për motora
9	SSH 2647:1989	Vaj lubrifikues (industrial)
10	SSH 26:1989	Tretësa
11	SSH 665:1988	Benzen
12	SSH 3653:1986	Ksilen
13	SSH 3689:1986	Toluen
14	SSH 21:1986	Bitum nafte
15	SSH 3596:1986	Acide naftenike
16	SSH 3647:1986	Sulfur nafte
17	SSH 3648:1986	Squfur
18	SSH 3654:1986	Sulfunat natriumi
19	SSH 3647:1986	Sulfur natriumi
20	STASH 69-95	Benzinë normale importi
21	STASH-EN 228-2000	Benzinë pa plumb
22	Vajgur avionesh	

II. Industria nxjerrëse dhe përpunuese e mineraleve
a)

1	SSH 1931:1986	Teknologjia e qymyreve
2	SSH 1872:1987	Përkufizimet dhe llojet e saldimit
3	SSH 1873:1987	Tipet kryesore dhe elementet konstruktive të tegelave të saldimit me hark

4.	SSH 2259:1987	Elektroda saldimi
5.	SSH 3929:1987	Gizë fonderie
6	SSH 3950:1987	Gizë e lidhur
7	SSH 3932:1987	Ferrokrom krabonik
8	SSH 857:1987	Kërkesat cilësore për shufrat e petëzuara prej çeliku të përdorimit të përgjithshëm
9.	SSH 858:1987	Çelik për përdorim të përgjithshëm
10.	SSH 856:1987	Kallëp prej çeliku për përdorim të përgjithshëm
11	SSH 3933:1987	Saldueshmëria e shufrave të lëmuara dhe të viaskuara prej çeliku të përdorimit të përgjithshëm
12.	SSH 1000:1987	Çelik me karbon për konstruksione
13.	SSH 1004:1987	Çelik për susta dhe balestra
14.	SSH 3166:1987	Gozhdë për traversa hekurudhore
15	SSH 3188:1987	Gozhdë dekovili
16	SSH 3191:1987	Pjastra shinash dekovili
17	SSH 838:1987	Kallëpe bakri blistër
18	SSH 839:1987	Bakër anodik
19	SSH 840:1987	Bakër elektrolitik
20	SSH 841:1987	Bakër i rafinuar
21	SSH 842:1987	Kallëpe bronxi
22	SSH 843:1987	Kallëpe tunxhi
23	SSH 844:1987	Kallëpe ari
24	SSH 845:1987	Kallëpe argjendi
25	SSH 846:1987	Selen teknik

b) Lista e makinerive me destinacion për punime minerare

c) Lista e makinerive në destinacion fabrika pasurimi dhe nyje copëtimi në sipërfaqe

d) Pajisje elektrike për industrinë minerare

e) Pajisje vetjake për minatorë

f) Minerale të ndryshme

1. Mineral kromi
2. Koncentrat kromi
3. Ferrokrom
4. Mineral bakri
5. Koncentrat bakri
6. Mineral nikel-silikati
7. Mineral qymyrguri
8. Qymyr koks

III. Pajisje dhe materiale elektrike:

a) Çdo material elektrik që përdoret në impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike, si dhe çdo pajisje që përdor energjnë elektrike pavarësisht nga numri i fazave dhe tensioni që përdorin, qofshin këto të prodhuara në vend ose të importuara.

b) Të gjitha pajisjet elektrike për përdorim shtëpiak.

IV. Produkte kimike:

1	SSH 1320:1987	Karbur kalciumi
2	SSH 2947:1987	Gëlqere e kloruar
3	SSH 1321:1987	Pleh kimik për lule
4	SSH 1323:1987	Nitrat amoni
5	SSH 1324:1987	Ure
6	SSH 949:1987	Helm kundër minjve
7	SSH 951:1987	Lindan pluhur
8	SSH 991:1987	Përzierje lindan-diptereks
9	SSH 998:1987	Zinoksevinë pluhur
10	SSH 999:1987	Sevine pluhur
11	SSH 1325:1987	Helm kundër molës
12	SSH 1398:1987	Diptereks
13	SSH 3602:1987	Tuba izolimi elektrik prej PVC-je të fortë
14	SSH 3856:1987	Kokrrizë PVC-je për veshjen e telave
15	SSH 938:1987	Shirit elektroizolues
16	SSH 996:1987	Guarnicione hermetizuese për kundërgaze

17	SSH 2862:1987	Valvol për kundërgaze
18	SSH 2890:1987	Tapë e hyrjes së ajrit në kutinë e kundërgazit
19	SSH 2892:1987	Tub bashkues i kundërgazit
20	SSH 2928:1987	Guarnicionet e sheshtë
21	SSH 2929:1987	Kapuç i kundërgazit
22	SSH 2641:1987	Amonit
23	SSH 2646:1987	Fitil ndezës
24	SSH 1346:1987	Fluorosilikat natriumi
25	SSH 1360:1987	Fikëse zjarri me ujë
26	SSH 1361:1987	Fikëse me shkumë
27	SSH 3651:1987	Karboksil metil celuloze
28	SSH 698:1987	Protoksit azoti
29	SSH 1303:1987	Gaz karbonik
30	SSH 1304:1987	Hidrogjen
31	SSH 1422:1987	Oksigjen
32	SSH 1423:1987	Gaz sulfuror
33	SSH 306:1987	Çizme të presuara
34	SSH 903:1987	Çizme gome (pa llustër)

V. Industria mekanike dhe e drurit

Makineritë metalprerëse

VI. Pajisje nën presion

Të gjitha pajisjet nën presion stacionare (kaldaja dhe enët nën presion), enët e thjeshta nën presion dhe pajisjet nën presion transportuese (bombola, fuçi, çisterna automobilistike) presion maksimal të lejuar më të madh se 0.5 bar.

ISPL

VII. Industria e lehtë

Nr.	Emërtimi i produkteve sipas grupit	Standartet referuese
1	2	3
1	Lëndë të para natyrale e sintetike që përdor industria -Lëndë të para për prodhim produktesh: qelq-qeramike, gomë-plastike, tekstile e këpucë dhe artikuj galanterie, letër etj.	SSH 1581/88; SSH 683/88 SSH 1581-2/88; SSH 1581-2/88; Përcaktimi Pb, Be, Cd metodike SSH 3857/87; SSH 3858/87; SSH 1150-11/1989
2	Enë në kontakt me ushqimin -Enë prej qeramike, qelqi e plastike dhe druri	SSH 2909/3-87; SSH 2909/1-87; SSH ISO 8391/1-96; SSH 9098-96; EN-101; SSH 2229/87; ISO 719-85; SSH 1388/10-87; SSH 2596/87; SSH 3608/87. Përcaktimi Pb, Be, Cd metodike
3	Ambalazhe në kontakt me ushqimin e transportin e produkteve të rrezikshme -Ambalazhe qelqi e qeramike, prej plastike, tekstili, letre e druri, (shishe, kavanoza, kuti, qese pëlhure, qese letre, bidona, fuçi, qypa, voza, kade etj.)	SSH 2596/87;* SSH 1029/88; SSH 3609/87; SSH 3617:2001 Përcaktimi Pb, Be, Cd metodike
4	Lodra për fëmijë -Lodra prej qelqi e qeramike, tekstili, gome e plastike dhe me veshje lëkure natyrale e sintetike dhe druri.	EN 71; EN ISO 14184; SSH 3931/87. Përcaktimi Pb, Be, Cd metodike SSH 1150-11/1989
5	Mjete kozmetike -Mjete kozmetike prej qelqi e qeramike, plastike, tekstili e lëkure (ruaza, vathë, varëse e rripa të ndryshëm, furça me qime të ndryshme etj., në kontakt me trupin e njeriut)	SSH 2596/87 SSH 891/98; SSH 2324/88; SSH 3608/87 Përcaktimi Pb, Be, Cd metodike SSH 1150-11/1989
6	Mjete mbrojtëse vetjake -Veshje mbrojtëse-rroba-pune dhe uniforma të profesioneve të caktuara prej tekstili, lëkure natyrale e sintetike, me pjesë gome e plastike -Mjete mbrojtëse për tabanin e këmbës dhe nga shkarjet (këpucë speciale) -Mjete mbrojtëse prej plastike e gome për mbrojtjen e kokës, fytyrës, dëgjimit, syve, frymëmarrjes, (maska, kaska, syze etj.) -Mjete mbrojtëse ndaj rrymës elektrike që kanë në përbërje pjesë gome, qelqi e qeramike. -Mjete mbrojtëse për këmbën:	SSH 658-4/88; SSH 658-6/88; SSH 658-7/88; SSH 658-10/88; SSH EN 340; SSH EN 510; SSH 1824/88; SSH 986/89; SSH EN 388/99; SSH EN 342; SSH EN 471; SSH EN 465; SSH EN 466; SSH EN 467; SSH EN 367/99; SSH EN 368/99; SSH EN 369/99; SSH 373-2000; SSH EN 374-1/2000; SSH 374-2; SSH EN 374-3; SSH 303/87; EN 397; EN 352-1;

	-këpucë të sigurisë për përdorim profesional -këpucë e çizme për të gjitha moshat	EN 352-2; EN 352-3; EN 136; EN 140; SSH 198/87; SSH 306/87 SSH 932/87; SSH ISO 3910/2000; SSH 1150 -11/1989; SSH EN 345 AL/2000; SSH EN 345/2/2000; SSH EN 246 AL/2000; SSH EN 346/2/2000;
7.	Artikuj hidro-sanitare që përdoren në mjekësi si dhe ato që paraqesin rrezik dermatologjik e alergjik -Artikuj prej qelqi farmaceutik dhe sanitar -Artikuj prej tekstili që përdoren për mjekësinë në kirurgji si fasho (marle) pambuk, pambuk hidrofil etj. -Artikuj prej tekstili në kontakt me trupin e njeriut si veshje të brendëshme e kryesisht për fëmijë, biankeri, piceta higjenike, shtroje dyshemeje etj.	SSH UNI 7530; SSH 658/88; SSH 683/88 SSH 658-10/88; SSH EN 20139/98; SSH 268/88; SSH 680/88; SSH 607/88; SSH EN 20139/98; SSH ISO 6925/2000; SSH ISO 9239- 1/2000; SSH ISO 11377/2000; SSH ISO 2094/2000; SSH 1010/88; SSH 1011/88;
8	Artikuj për përdorim teknik dhe veprimtari të ruajtjes nga zjarri -Artikuj qeramike për përdorim industrial (pllaka të ndryshme) -Materiale zjarrduruese prej qelqi e qeramike -Materiale e produkte prej fibrash e fijesh tekstili (fitila furnelash, tekstile për filtra, rrjeta, litare, çadra për ushtrinë, gjeotekstile, tuba zjarrfikësi, rripa transmisioni, kopertona, shirita izolues me veshje pambuku, perde e grila me fibra qelqi, tekstile të gomuara, pa thurje, fill për qepje për artikuj tekstil industrial etj.) -Materiale gome e plastike (tuba të llojeve të ndryshme prej PVC-je e gome, rakorderi PVC, PE dhe PP etj.)	SSH 1380/87; SSH 548-2; SSH EN 202; SSH 1619/87; SSH 1384/87; SSH 1385/87; SSH 2597/87; SSH 658/88; SSH ISO 9872-2/2000; SSH ISO 11058/2000 SSH ISO 12236/2000; SSH ISO 12960/2000; SSH ISO 13431/2000; SSH 392-2/87; SSH 462/88; SSH 931/87; SSH ISO 4878/2000; SSH ISO 3090/2000; SSH ISO 2307/2000; SSH ISO 5473/2000; SSH ISO 5470-1/2000; SSH ISO 4674/2000; SSH ISO 1420/2000; SSH 605/88; SSH 604/88; SSH 602/88; SSH 652/88; SSH 1419/2000; SSH 610/88; ISO/TR 10358:1993; SSH UNI 7991:1997; SSH 3862-4/1987

SHTESË AUTORIZIMI ZYRTAR
Nr.1, datë 20.7.2002

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të Ligjit nr. 8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit", si dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, me vendim nr.20, datë 19.7.2002:

A U T O R I Z O N:

Shoqëria anonime "Siguria e Madhe" Sh.a, me emrin e shkurtuar “SIGMA” sh.a. me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e rrethit Tiranë me nr. akti 20484, të kryejë sigurime për dëmet, në përputhje me lejen e riformuluar dhe për zgjerim aktiviteti.

Leje e riformuluar për zgjerim të aktivitetit të sigurimeve dhe/ose risigurimeve

Shoqëria e sigurimeve "Sigma" sh.a. e regjistruar në gjykatën e rrethit Tiranë me nr.akti 20484

me seli në Tiranë në adresën Sheshi Wilson, që ushtron aktivitet në fushën e sigurimeve në bazë të autorizimit nr.1, datë 3.2.1999, lejohet të zgjeroj aktivitetin e saj të sigurimeve edhe në grupe të tjera të papërfshira në lejen e mëparshme, bazuar në lejen e riformuluar në përputhje me shtojcën B të ligjit nr. 8081 datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë në sigurime dhe/ose risigurime" si më poshtë vijon:

Grupi nr.1 dhe nr.2 "Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit".

Grupi nr.1 (paragrafi i katërt) 3,7 dhe 10 "Sigurime motorrike".

Grupet nr.1 (paragrafi i katërt) 4, 6, 7 dhe 12 "Sigurimi i marinës dhe transportit".

Grupet nr.1 (paragrafi i katërt) 5,7 dhe 11 "Sigurimi i avionëve".

Grupet nr.8 dhe 9 "Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë".

Grupet nr.10, 11,12 dhe 13 "Sigurimi i përgjegjsive"

Grupet nr.14 dhe 15 "Sigurimi i kreditit dhe garancive".

Kjo leje e riformuluar dhe për zgjerim aktiviteti është pjesë përbërëse dhe i bashkëngjitet shtesës së autorizimit zyrtar nr.1 datë 20.7.2002.

U lëshua sot më datë 11.11.2002 nga Komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve dhe i shtrin efektet menjëherë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar).



U dorëzua për shtyp më 26. 12. 2002
Doli nga shtypi më 26. 12. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë